



**Republika e Kosovës**  
*Republika Kosova – Republic of Kosovo*  
**Komuna e Vitisë**  
*Opština Vitina – Municipality of Vitina*



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

12-03-2019

Pranuar / Prinjeto / Më / Çmim			
Nr. i organit / Org. broj	Numri / Broj	Shënim / Prillog	Vlera / Vrednos
12-060/01-241			

Viti, 12 mars 2019

**Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Vitisë, u bën:**

## **THIRRJE PUBLIKE**

1. Të gjitha organizatat jo-qeveritare të Regjistruara në Republikën e Kosovës që veprojnë në Komunën e Vitisë, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, dhe që përfshijnë aktivitete të realizuara në Komunën e Vitisë të aplikojnë për mbështetje financiare:

### **Në fushën e kulturës:**

- Promovimi dhe afirmimi i vlerave kulturore.
- Promovojnë krijimtarinë lokale artistike;
- Promovojnë diversitetin lokal kulturor dhe nxisin dialogun artistik ndërkulturor;
- Promovojnë trashëgiminë kulturore;
- Kontribuojnë në shtrirjen e kalendarit kulturor përgjatë tërë vitit;
- Kontribuojnë në zhvillimin e turizmit kulturor lokal;
- Nxisin pjesëmarrjen e audiencave të reja në jetën kulturore;
- Festivalet, koncertet, shënimet e datave historike - kulturore, simpoziumet dhe ekspozitat.
- Grupet/shoqëritë kulturore-artistike që funksionojnë në Komunën e Vitisë, mbështeten bazuar në realizimin e suksesshëm të programeve të tyre kulturore dhe artistike në vitet paraprake.

### **Në fushën e rinisë**

- Fuqizimi i rinisë
- Mbështetja dhe fuqizimi i organizatave rinore në zhvillimin e aktiviteteve specifike për të rinjtë që ndikojnë drejt për së drejti në nxitjen e aktiviteteve në fushat e ndryshme të përfshirë në Strategjinë Kosovare për Rini dhe Plan të Veprimit
- Mbështetja për përfshirjen sociale dhe organizimi i ngjarjeve provuese dhe rekreative.
- Mbështetje të personave me nevoja të veçanta dhe inovacion teknologjik

## Në fushën e sportit

- Zhvillimi i sportit në Komunën e Vitisë
  - Masivizimi i sportit për të rinj,
  - Përkrahja për sportistët kulmorë dhe klubet sportive
  - Organizimi i aktiviteteve sportive
  - Projektet të ndryshme me grup-mosha të ndryshme,
  - Ngritja e nivelit profesional të klubeve sportive,
  - Aktivitete edukative me simpatizantë me qëllim kultivimin e vlerave fisnike të sportit,
2. Vlerësimi i projekteve do të bëhet nga një komision profesional 5-anëtarësh, të cilët do të vlerësojnë projektet në bazë të kriterëve për vlerësim dhe sipas rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.

### Vlerësimi do të bëhet sipas:

1. Plotësimi të kushteve administrative të aplikimit;
  2. Ndërlidhjes me objektivat e thirrjes;
  3. Kapacitetit të dëshmuar organizativ dhe menaxhues;
  4. Vazhdimësisë së realizimit të programit dhe qëndrueshmërisë së tij;
  5. Njohjes ose kontributit për afirmimin ndërkombëtar të qytetit të Vitisë;
  6. Cilësisë artistike të projektit;
  7. Originalitetit të projektit.
3. **Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve janë:**
- Formulari i Aplikacionit për projekt/programit **F-9** (word e shtypur);
  - Formulari i Propozim buxhetit **F-10** (format Excel e shtypur);
  - Formulari i deklaratës për mungesë të financimit të dyfishtë **F-11** (format word e shtypur);
  - Formular i deklaratës së partneritetit **F-12** (format word e shtypur);
  - Forma e deklaratës së projekteve të financuara **F-13** (format word e shtypur);
  - Deklarata e përbashkët **F-14** (format word e shtypur)
  - Dokumenti identifikues (fotokopje e shtypur);
  - Certifikata e regjistrimit OJQ dhe Numri Fiskal (fotokopje e shtypur);
  - Konfirmim nga banka për xhironlogarinë e aplikuesit.
  - Deklaratë e dorëzimit të pasqyrave financiare vjetore të deklaruara në ATK për vitin
  - Vërtetim mbi kryerjen e të gjitha detyrimeve tatimore ndaj ATK-së;
  - Dëshmi të implementimit të projekteve/programëve të ngjashme
  - CV-ja e menaxherit të projektit (word);
4. Formulari për aplikim mund të merret në ueb-faqe të Komunës apo në zyrat e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe mund të dorëzohen duke filluar nga data **12 mars 2019 deri më 01 prill 2019 ora 15:00** (15 ditë pune sa zgjat konkursi i hapur). Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.

## Aplikimet

1. OJQ-të në kuadër të kësaj thirrjeje mund të aplikojnë më së shumti me një projekt, për secilën nga fushat e thirrjes.
2. Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të, që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave Jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës, të cilat veprojnë në Komunën e Vitisë.
3. Aplikuesit duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në njërin nga fushat e aplikimit.
4. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Komunës së Vitisë - Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.
5. Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja, ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.
6. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare të Komunës së Vitisë.
7. ***Dokumentet e kompletuara në kopje fizike dhe CD duhet të dorëzohen te Zyra e protokollit (Arkivi) Nr.1 në ndërtesën e Komunës së Vitisë  
Për: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit***
8. Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.
9. Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

## Vërejtje:

Projektet të cilat nuk i kanë të bashkangjitura dokumentet sipas kërkesës nuk do të merren parasysh nga Komisioni për shqyrtimin e kërkesave. Shpenzimet të cilat nuk do të mbështeten janë ato administrative, renovimet, pagat, dhuratat, shpërblymjet dhe të ngjashme. Për çdo informatë dhe për të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: [dkrs.subvencionet@gmail.com](mailto:dkrs.subvencionet@gmail.com)

Me respekt,  
Drejtori, Milot LALA



121